



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
MINISTRI

URDHER Nr. 359 date 05/09/2013

PER
RUAJTJEN DHE ARKIVIMIN E PROCESVERBALIT TE SEANCES GJYQESORE APO TE
VEPRIMEVE TE TJERA PROCEDURALE QE ZHVILLOHEN JASHTE
SEANCE

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 e Kushtetutes, te nenit 7, pika 2 te Ligjit Nr. 8678, date 14.05.2001, "Per organizimin dhe funksionimin e Ministrise se Drejtesise", i ndryshuar, si dhe nenit 118 te Ligjit Nr. 8116, date 29.3.1996 "Kodi i Procedures Civile i Republikes se Shqiperise", te ndryshuar,

URDHEROJ:

1. Procesverbali i seances gjyqesore apo i veprimeve te tjera procedural qe zhvillohen jashte seance, te mbajtura nepermjet regjistrimit audio ose audioviziv apo ne formen e nje permbledhje te sakte me shtypshkrim apo doreshkrim, si pjese perberese e dosjes gjyqesore, arkivohet dhe ruhet per aq kohe sa ruhet vete dosja gjyqesore.
2. Rregullat per ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit te mbajtur nepermjet regjistrimit audio ose audioviziv, percaktohen ne udhezimin nr. 353, date 03.09.2013 te Ministrit te Drejtesise "Per percaktimin e rregullave te hollesishme per mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit te seances gjyqesore me mjete audio".
3. Procesverbali i mbajtur ne formen e nje permbledhje me shtypshkrim apo doreshkrim ruhet ne dosjen gjyqesore dhe arkivohet duke ndjekur rendin kronologjik te akteve ne dosjen gjyqesore, ne baze te nenshkrimit te sekretares gjyqesore si dhe me vulen e gjykates. Atij mund t'i bashkelidhen edhe shpjegimet dhe pretendimet me shkrim te paraqitura nga palet, ne mbeshtetje te kerkesave dhe konkluzioneve te tyre, ne perputhje me nenin 172 te Kodit te Procedures Civile.
4. Palet, personat e trete te thirrur ne gjykate si dhe personat e interesuar mund te terheqin kopje te procesverbaleve te arkivuara ne dosje, te regjistrimeve te mbajtura me mjete te regjistrimit audio ose audiovizive, transkripte te plota ose te pjesshme te ketyre te fundit, si

dhe ekstrakte autentike te akteve te perpiluara me shtypshkrim apo doreshkrim kundrejt pageses dhe me lejen e gjykates ne perputhje me rregullat e parashikuara ne nenin 77 te Kodit te Procedures Civile.

5. Ne cdo rast e drejta e paleve dhe e publikut per t'u njohur me dosjen gjyqesore perfshin edhe te drejten per t'u njohur me procesverbalin e seances gjyqesore.
6. Ngarkohen gjykatat e shkalles se pare dhe gjykatat e apelit per zbatimin e ketij Urdhri.
7. Ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e ceshtjeve te Drejtesise ne Ministrine e Drejtesise per ndjekjen e zbatimit te ketij urdhri.
8. Ngarkohet Sekretari i Pergjithshem per njoftimin e ketij urdhri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
EDUARD HALIMI